

STATUTI I

SHOQERISE "A&M" SHPK

KRIJIMI, FORMA, EMERTIMI, OBJEKTI, SELIA E SHOQERISE, KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Neni 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "A&M" SH.P.K,eshte nje shoqeri e themeluar nga ortaku:

1.Elidon Leven Malaj i datelindjes 02.03.1974, lindur ne Salari dhe banues ne Tepelene i cili me zotesi te plote per te vepruar dhe vullnet te pa vesuar ka vendosur qe shoqeria te marr formen e nje shoqerie tregtare me pergjegjsi te kufizuar (SH.P.K.) ne perputhje me ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"

Neni 2

Shoqeria "A&M" eshte person juridike dhe si e tille fiton personalitetin juridike me regjistrimin e saj ne organet perkatese kopetente dhe rregjistrimin e saj ne Regjistrin Tregtare.

Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe me dispozitat e ketij statute dhe aktit te themelimit, veprimtari te cilen e ushtron ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj. Shoqeria udhehiqet na parimet e ekonomis se tregut dhe ka per qellim fitimin. Ajo respekton parimin e reciprocitetit.



Neni 3

Me vendim ortaku mund te ndryshoje regjimin juridik te shoqerise, nese ne te ardhmen do te krijohen premisa me te favorshme per funksionimin e saj ne perputhje me ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare". Ne kete rast ortaku do pershtase aktin e themelimit dhe statutin e shoqerise si dhe te bejne ndryshimet e tyre ne regjistrin tregtar dhe ne organet kopetente shqiptare.

Neni 4

Shoqeria "A&M" shpk mund te hap adresa te tjera brenda te njejtit NIPT si: filiale, perfaqesi, dege dhe te gjitha llojet e adresave dytesore ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe me ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.

Neni 5

Forma e kesaj shoqerise eshte SHPK(shoqeri me pergjegjesi te kufizuar) dhe i perballon humbjet deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre ne kapitalin themeltar

Neni 6

Emri i shoqerise eshte "A&M" SHPK



Neni 7

Selia e shoqerise eshte ne qytetin e Tepelenes, Rruga Kombetare Tepelene-Memaliaj, por gjithmone ajo mund ta ndryshoje qendren e saj sipas nevojës me vendim te ortakut, vendime te cilat nuk duhet te jene ne kundërshtim me legjislacionin ne fuqi apo me dispozitat e ketij statuti.

Neni 8

Kohezgjatja e shoqerise eshte per nje afat te pa percaktuar duke filluar nga data e rregjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtare . Kjo periudhe mund te ndryshoje ne rast se shoqeria prishet ne cdo kohe dhe per c'faredo shkakut por gjithemone ne perputhje me ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe rregullave te percaktuara ne statut.

Neni 9

Vula e shoqerise "A&M" eshte vule rrethore me mbishkrimin **A&M sh.p.k,IMPORT-EXPORT,TEPELENE- ALBANIA**

Neni 10

Shoqeria ka per objekti te saj:

- Importi dhe eksporti i produkteve industriale dhe ushqimore
- Shitja me pakice e hidrokarbureve dhe nenprodukteve te tyre
- Bar-Kafe
- Servis Automjetesh
- Tregeti me shumice dhe pakice te artikujve industrial dhe ushqimore.



II. KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTI DHE PJESET

Neni 11

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar “**A&M**”, SHPK ka nje kapital fillestar prej **100.000 leke** i perbere ne 100 pjese me vlere nominale secila pjese 1.000leke.

Ortaku ka derdhur kontributin e vete brenda ketij kapitali. Kontributi i ortakut ne kapitalin themeltar kap vleren 100% te tij.

Ky kapital eshte i nenshkruar dhe i shlyer nga ortakut. Shoqeria mund ta shtoje ose pakesoj kapitalin e saj me vendim te ortakut gjithmon ne perputhje me ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”

Kapitali fillestar i investuar nga ortakut i vetem themelues perben bazen e krijimit te fondit themelor te mjeteve te xhiros.

Administratori i dorezon ortakut te vetem dokumentin vertetues per sasite e shumave te derdhura ne fazen e themelimit.


Vlersimi i kapitalit ne natyr eshte ber nga ortakut i vetem themelues ne momentin e themelimit te shoqerise.

Shoqeria behet pronare e pasurise te luajtshme e te paluajtshme kur vlera e pasurise mbulohet teresishte ne te holla.

Neni 12

Pjeset e kapitalit jane lirishte te transferueshme tek persona te tjere nepermjet kontrates se shitblerjes te kuotave.

Keto kuota mund tu transferohen te treteve me vendim te ortakut dhe nepermjet kesaj kontrate. Gjithashtu pjeset e kapitalit jane lirishte te transferueshme ne rast ndarjeje pasurore nepermjet bashkeshorteve si dhe ne rruge trashegimie testamentare ose ligjore pas ydekjes se ortakut duke



respektuar radhet e trashegimise ne Kodin Civil. Transferimet duhet te vertetohen me akt noterial ndryshe jan te pa vlefshme.
Subjektet qe perfitojn nga ky transferim detyrohen te disponojne kapitalin e transferuar per nje vit ne shoqeri, duke pasur te gjitha te drejtat e mbajtsit te tij te meparshem.

III.ORGANET DREJTUESE

Neni 13

Organet drejtuese te shoqerise ‘‘A&M’’ SH P K jane:

- Asambleja e ortakeve
- Administratori

Neni 14

Fusha e veprimtarise, perberja dhe menyra e punes te organeve drejtuese do te rregullohet me kete statut.

Mbledhjet e shoqerise jane te zakonshme dhe te jashtezakonshme.

Mbledhjet e jashtezakonshme thiren ne cdo kohe kur organi administrativ e sheh te nevojshme. Vendimet e mbledhjes duhet te meren ne perputhje me ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 ‘‘Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare’’ statutin dhe aktin e themelimit.



IV.ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Neni 15

Ortaku i vetem themelues ka kopetencat e asambles se ortakve the administratorit te shoqerise. Asambleja vendos per:

- Asambleja e ortakve mblidhet te pakten nje her ne vit per miratimin e bilancit mbasi lajmerohet nga administratori 15 dite perpara me shkrime
- Asambleja e ortakeve drejtohet nga administratori. Ai emerone nje sekretar nga radhet e pjesmaresve per mbajtjen e procesverbalit te mbledhjesme perjashtim te rasteve kur ai duhet mbajtur na nje noter sipas ligjit
- Emerimin dhe shkarkimin e administratorit
- Emerimin dhe shkarkimin e ekspertit kontabel
- Emerimin dhe shkarkimin te likujdatorit
- Miratimin e raporteve te administratorit
- Miratimin e llogarive vjetore
- Ndarjes se fitimit dhe te mases se humbjes
- Ndryshimin e statutit
- Zvogelimin ose shtimin e kapitalit themeltar
- Transerimit te pjeseve te kapitalit
- Mbylljen e veprimtarise te shoqerise

Vendimet e mbledhjes fiksohen ne procesverbalin e firmosur nga administratori dhe sekretari ose noteri. Ne procesverbal duhet te pasqyrohen ne menyre te permbledhur deklaratat prej ortakut me kerkese te ketij te fundit

Si dhe te marr cdo vendim tjeter qe ka te beje me shoqerine por gjithmone ne perputhje me legjislacioni ne fuqi.



Neni 16

Shoqeria do ta konsideroj qendren e vete ne qytetin e Tepelenes si shoqeri Nene, e cila rast pas rasti do te zgjerohet me ane filialesh, degesh ose shoqeri te perbashketa ne te gjitha ato vendet ku do te shikoj interesa ne permbushje te qellimit te saj.

V TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKUT

Neni 17

Shoqeria ka te drejte te lidhe marveshjen dhe te nenshkruaje kontrata ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj.

-Ortaku ka per detyrim te depozitoj kuoten e kapitalit fillestar ne perputhje me aktin e krijimit si dhe te perballoje humbjen deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre ne kapitalin themeltar.

-Ortaku ka te drejte te bej propozime per emerimin she shkarkimin te eadministratorit, punonjesit, ekspertit kontabel apo likujdatorit.

-Ortaku ka te drejte ti transferoj kuotat e tij nepermjet kontrates se shitblerjes se kuotave personave te trete.

-Ortaku ka per detyr qe te kryej te gjitha detyrat e caktuara me par dhe te orientuara na administratori i shoqerise per aritjen e objektivave dhe funksionit te shoqerise si dhe te drejten te mare te gjitha informatat qe kane te bejne me veprimtarine prodhuese projektuese realizuese dhe tregtare te shoqerise

-Ortaku mer pjese ne administrimin e veprimtarise se shoqerise ne perputhje me aktin e themelimit dhe statutin vet ose nepermjete perfaqsesit te tij

-Ortaku ka te drejte te terheq te gjitha dokumentat kryesore te shoqerise per tre vitet e fundit te mara na administratori i shoqerise mntrelet dhe projektet e vendimeve

-Ortaku ka te drejte te jete pjesemares si ortake dhe ne shoqerite e tjera duke plotesuar detyrimet brenda shoqerise te percaktuara ne aktin e themelimit statutin dhe ne perputhje me ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"



- Ortaku ka per detyre te siguroj plotesimin e drejte, te plote dhe ne kohe te detyrime te veta si dhe cdo detyrimi tjeter ndaj shoqerise ne baze te aktit te themelimit, te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.
- Te depozitot kapitalin e shoqerise brenda afatit te parashikuar
- Temar pjes ne procesin e ritjes se nivelit te specialisteve
- Heqja dor e ortakut nga shoqeria nuk e perjashton ate na detyrimet financiare te mara me par ndaj shoqerise dhe nuk pezullon detyrimet ndaj ortakëve te tjer ose te treteve

VI.DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 18

Shoqeria mund te administrohet nga nje ose me shume administrator apo dhe nga nje keshill administrativ. Aktualishte ajo administrohet nga ortakut Elidon Malaj per nje periudhe 5 vjecare dhe konkretisht nga data 10.08.2012 deri ne daten 10.08.2017.

Neni 19

Administratori ose administratore mund te jene ose jo ortakut sipas percaktimit te asamblese.

Administratori shkarkohet me vendimim te asamblese ne cdo kohe me shumice te zakonshme ose mund te shkarkohet nga gjykata per shkelje te ligjit me kerkesë te ortakut.



Neni 20

Administratori i ka te gjitha kompetencat per te vepruar me te tretet ne emer te shoqerise per administrimin e veprimtarise se saj.
Per shitjet ose blerjet e pasurise se shoqerise, per procedurat e falimentimit, kompromisit dhe perfaqesimit ne organet gjyqesore duhet te pajiset me vendim te perkates nga ortaku.

VII TE DREJTAT E ADMINISTRATORIT

Neni 21

- Te miratoje planet e llogarive ekonomike pas perpunimit te tyre dhe te paraqese ato sipas rastit per miratim nga ortaket
- Te bej propozime perkatese tek ortaket kur lind nevoja per ndryshim ne kapitalin themeltare te shoqerise
- Administratoret jan pergjegjes individualisht dhe solidarisht ndaj shoqerise ose te treteve per shkelje te ligjeve per shkelje te statutit apo per deme te kryera gjat administrimit
- Te perfaqsoje shoqerine me te tretet ne te gjitha veprimet e saj
- Te pregatise te gjitha raportet mujore dhe vjetore te shoqerise
- Te siguroj zbatimin e perpikte te vendimeve te ortakeve
- Te pergjigjet per mbarvajtjen e perditeshme te shoqerise
- Administratori ka te drejte ti delegoj te drejtat e tij nepermjet nje vendimi me vulen e shoqerise.
- Te percaktoj strukturen e aparatit te shoqeris dhe te krijojte organe te tjera te domozdoshme per realizimin e objektiveve te shoqeris

Shoqeria mund te ket dhe keshill administrativ kur ajo e vlerson te nevojshme. Keshilli administrativ thiret nga administratoret e shoqeris per probleme te ndryshme. Njoftimi duhet te permbaj vendin, daten dhe oren e mbledhjes, si dhe ceshtjet qe do te trajtohen. Vendimet e mbledhjes meren nga administratori. Ato fiksohen ne procesverbal te firmosura prej tyre dhe sekretarit.



VIII.MARDHENIET E PUNES

Neni 22

Mardheniet e punes kjo shoqeri i rregullon nepermjet kontratave kolektive dhe individuale te punes te drejta dhe detyrime te percaktuara ne Kodin e Punes.Per ceshtjet qe nuk rregullohen me kontraten e punes zbatohen dispozitat e legjislacionit ne fuqi.

Mosmarveshjet midis punonjesve dhe shoqerise nese nuk zgjidhen me marveshje do te zgjidhen nga gjykata.Punonjesit e emeruar nuk marrin pjese ne ndarjen e fitimeve te realizuar nga shoqeria gjate veprimtarise se saj nese ne kontraten e punes nuk eshte parashikuar ndryshe. Te gjithë punonjesit e punesuar te cilet pranojne kete statut do te pergjigjen per demet qe ata i sjellin shoqerise.

Kriteret e pergjithshme te punesimit te personave te tjere, numrin e punonjesve , kufinjte e pageses dhe detyrimet e secilit ne shoqeri caktohen sipas legjislacionit perkates.

Neni 23

Te gjitha mosmarveshjet qe mund te lindin gjate egzistences se shoqerise midis saj dhe te treteve do te zgjidhen me mirekuptim, nese nje gje e tille eshte e pa mundur atehere keto mosmareveshje do te zgjidhen ne Gjykatën Kompetenete.



IX BILANCI DHE TE ARDHURAT

Neni 24

Shoqeria kryen veprimtarin e saj per te realizuar fitimin duke u mbeshtetur ne parimin e likujditetit, sigurise dhe rentabilitetit.

Veprimtaria e shoqerise pasqyrohet ne bilancin perkates

Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet financiare te vitit, raportet e vecanta te hartuara nga administratori dhe ato te ekspertit kontabel do te miratohen nga ortaku.

Veprimtaria e funksionimit te shoqerise bazohet ne kerkesat e ekonomise se tregut

Bilanci vjetor paraqitet brenda dates 31 Mars te vitit pasardhes .Forma e bilancit percaktohet na administratori ne harmoni me format e bilanceve te vendosura ne Republiken e Shqiperise.pasuria e shoqerise vlersohet ne bilancet e saj ne monedhen e vendit , ne monedhe te huaj, sipas vlersimit te ortakut ose eksperteve ne momentin e themelimit te shoqerise.


Neni 25

Shoqeria vendosi garanci pasurin e saj per te garantuar detyrimet kundrejt te treteve ose per te mar kredi bankare.

Shoqeria krijon fonde rezerv ose fonde te vecanta dhe disponon mjetet e veta financiare per te perballuar nevojat e saje ekonomike.

Neni 26

Pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimit te egzistences se fitimit , ortaku mer pjesen qe i takon sipas perqindjes se kontributit te derdhur, ne formen e dividendit mbi fitimin. Fitimin qe perfiton ortaku perbehet nga fitimi i vitit financiar te cilit i jane zbritur shumat e lena menjane per fondet rezerve te domosdoshme te percaktuara nga ortaku, te fondeve te tjere qe shihen te nevojshme te lena per investime dhe reklama tregtare dhe nga ana tjeter jane shtuar ose zbritur respektivisht fitimet apo humbjet e mbartura nga vitet e meparshme.



E ardhura neto e shoqerise qe rezulton nga bilanci pasi zbriten shpenzimet e bera per kryerjen e cdo lloj aktiviteti, nga zbritja e vleres se amortizimit nga tatimet dhe taksat, nga kuotat qe risin kredin per investime, paga dhe shperblimet perdoren nga ortakut sipas qellimit te tij. Kontrolli i shoqerise kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar i emeruar me mundesi rizgjedhjeje. Shkarkimi i ekspertit kontabel behet sipas dispozitave te ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

Pasurit e krijuara na shoqeria gjat aktivitetit te saj jan ne pronesi te ortakut. Ato mund te tjetersohen, te jepen me qira, te lihen peng dhe hipotek me miratimin e ortakut.

Neni 27

Plani financiar parashikon aktivin dhe pasivin e aktivitetit ekonomik te shoqerise, te shprehur ne lek ose ne valut te konvertueshme. Llogaria ekonomike do te mbahet ne Shqiperi. Shkembimi i monedhes Shqiptare dhe anasjelltas behet sipas kursit zyrtar ose privat te shkembimit

X SHPERBERJA E SHOQERISE DHE LIKUJDIMI

Neni 28

Veprimtaria e shoqeris mund te nderpritet para afatit kur shoqeria nuk rezulton rentabel gjat dy viteve te fundit radhazi dhe kur per kete vendos gjykata kopetente. Por shperberja e shoqerise mund te vije ne cdo kohe dhe per cfaredo shkak si pamundesi veprimi me vendim te ortakve, forca madhore dhe faktor te tjer qe nuk varen nga ortakut. Ne keto raste ortakut e shoqerise vendosin mbi menyren e likujdimit dhe caktojne nje ose me shume likujdues duke ju percaktuar dhe detyrate. Administratoret dhe likujdoret jane pergjegjes per ruajtjen e pasurise derisa tu dorezohen personave fizike dhe juridike duke likujduar ne rradhe te pare detyrimet ndaj personave te trete qe ka shoqeria.



Neni 29

Shoqeria hyn ne procesin e likujdimit qe ne momentin e mbarimit te saj. Per kryerjen e ketij procesi asambleja e ortakeve cakton nje ose disa likujdator te cilet i paraqesin asaj raportet mbi gjendjen e aktivitetit dhe te pasivitetit, mbi ndjekjen e operacioneve te likujdimit mbi afatin e duhur te perfundimit te tyre.

Ne fund te procesit te likujdimit ortaket vendosin per bilancin perfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e procesit te likujdimit. Pas pagimit te kreditoreve dhe shlyerjes se pjeseve te kapitalit themeltar tek kontribuesi perkates, likujduesi i kalon kapitalin e mbetur ortakeve.

Neni 30

Per sa nuk eshte shprehur ne kete statut i referohemi plotesimeve qe behen perputhje me ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe legjislacionin ne fuqi

Ky statut u hartua ne 2 kopje, ku njeri u depozitua ne QKR .

